



DualAFS - Programi i studimeve të integruara me punë praktike në bujqësi dhe sigurinë ushqimore

Programi i BE-së:	Erasmus +
Nënprogrami:	Bashkëpunimi për inovacionin dhe shkëmbimin e praktikave të mira
Masa KA2:	Ndërtimi i Kapaciteteve në Arsimin e lartë (CBHE)
Kohëzgjatja:	15.01.2021 - 14.01.2024

E-Newsletter Numër 1, Korrik 2021

Mendimi juaj është shumë i rëndësishëm!

Projekti Erasmus plus „Dual Curricula - Study and Work Practice in **A**griculture and **F**ood **S**afety” synon të implementoj, në fushën e bujqësisë dhe ushqimit, modelin e studimeve Bachelor të integruara me praktikën. Për të zhvilluar kurrikulën e studimeve të integruara me praktikën është e domosdoshme të njihen mirë nevojat e tregut të punës në këtë sektor, pritshmëritë e punëdhënësve për nivelin e formimit profesional të të diplomuarëve në fushën e bujqësisë dhe ushqimit, si dhe për bashkëpunimin e universitetit me fermat/bizneset. Në mënyrë që të studjohen me bazë të gjithë këto aspekti, projekti Erasmus në fjalë zhvillon një Survey, mbështetur edhe në pyetësorë dhe intervista të strukturuar.

Duke çmuar shumë kohën e njërëzve të sipërmarrjes, të institucioneve dhe të studentëve, grupi i punës i projektit është përpjekur të hartoj një pyetësor të qartë dhe të thjeshtë, i cili kërkon sa më pak për tu plotësuar. Ne do të ishim shumë të kënaqur nëse ju do të kishit kohë dhe mundësi për tu takuar me ne edhe për të plotësuar këtë pyetësorë. Por jemi të vetdijshëm se axhenda juaj është shumë e ngarkuar. Për këtë arsye grupi i projektit ka adaptuar edhe metodën e plotësimit të pyetësorit online ose përmes e-mailit.

Ne do t'ju ishim shumë mirënjohës, nëse ju do të gjeni pak kohë për të plotësuar pyetësorin që po ju dërgojmë, çka do të jetë një kontribut shumë i çmuar për hartimin e programit Bachelor, i cili do të përgatisë brezat e specialistëve të rinj, të cilët do të kontribuojnë në zhvillimin agrobiznesit, prodhimit shtazor, ushqimit dhe sigurisë ushqimore në Shqipëri dhe Kosovë.

[Linku për pyetësorin](#)

Ne ju falenderojmë për këtë kontribut të cmuar.

Mbi projektin

Projekti DualAFS është një projekt në kuadër të programit Erasmus+ të BE në fushën e arsimit të lartë në Shqipëri dhe Kosovë. Ai synon punësim më të mirë të të diplomuarve, njohuri dhe kapacite për inovacione në bujqësi dhe shkenca blegtorale dhe përmirësimin e konkurrueshmërisë së bujqësisë dhe biznesit të ushqimit për të arritur të ardhura më të larta në të ardhmen. Në këndvështrimin afatgjatë, qëllimi është të ndihmoj në zhvillimin e zonave rurale dhe atyre më të varfëra të Shqipërisë dhe Kosovës.



Objektivat

Projekti DualAFS zhvillon njohuritë e studentëve dhe përfituesve të tjerë nga sektorët dhe nënsektorët e bujqësisë, blegtorisë dhe cilësisë e sigurisë së produkteve blegtorale. DualAFS internacionalizon shkollimin e lartë në fushën e bujqësisë, përshpejton inovacionin dhe krijon ura bashkëpunimi dhe lidhjet universiteteve dhe partnerëve të tjerë në nivelet e ndryshme të sektorit. Gjithashtu, ky projekt përmirëson hapjen e universitetit drejt ekonomisë dhe tregut të punës, përmes digjitalizimit dhe kapaciteteve të tjera për formimin e studentëve.

Për të përmbushur këto objektiva, projekti DualAFS:

- zhvillon dy programe studimore inovative Bachelor, duke integruar mundësinë e praktikës dhe mjeteve
- përmirëson orientimin dhe lidhjen e teorisë me botën reale të punës dhe profesionit, përmes integritimit të studimeve me praktikën

dhe materialeve interaktive digjitale përmes e-learning:

- Programi Dual Bachelor “Zootekni dhe Siguria e produkteve blegtorale” në Universitetin Bujqësor të Tiranës (UBT);
- Programi Dual Bachelor “Agrobiznes” në Universitetin “F.S.Noli” Korçë (UNIKO);

profesionale në ferma/biznese dhe bashkëpunimit të ngushtë të universitetit me partnerët e tregut të punës të agrobiznesit, prodhimeve blegtorale dhe sigurisë ushqimore;

- zhvillon kapacitetet e universitetit për “Trajnimin e vazhduar” (*Lifelong Learning*) për të tretë nga nënsektorët e lartëpërmendur;
- zhvillon kapacitete për *E-learning* për studentët dhe për transferimin e njohurive nga universiteti në nënsektorët e blegtorisë, agrobiznesit dhe sigurisë ushqimore.

Grupet përfituese

Studentët

.... nga programet e studimeve Bachelor:

- „Zootekni dhe siguria e produkteve blegtorale“ të Universitetit Bujqësor të Tiranës;
- „Agrobiznes“ të Universitetit të Korçës;
- „Menaxhimi i biznesit blegtoral“ të Universitetit të Prishtinës;
- „Inxhinieri dhe teknologji ushqimore“ të Universitetit të Mitrovicës.

Personeli akademik

Pedagogët e universiteteve do të zhvillojnë mësim të orientuar nga praktika si në

- përmbajtjen e programit, ashtu edhe në
- metodat e mësimdhënies.

Për këtë qëllim, pedagogët e universiteteve, instruktorët e praktikës si dhe personeli ndihmës akademik, do të trajnohen për zhvillimin dhe implementimin e programeve duale si dhe për modernizimin e praktikës profesionale në ferma dhe biznese të bujqësisë, blegtorisë dhe ushqimit.

Fermerët, bizneset e bujqësisë, blegtorisë dhe ushqimit

Grupi i tretë përfitues janë fermat dhe bizneset e bujqësisë, blegtorisë dhe ushqimit.

Për të implementuar programet duale dhe për të modernizuar pjesën e praktikave profesionale të tyre, është e domosdoshme praktika profesionale e studentëve në ferma/biznese.

Feramat dhe bizneset janë partnerë të domosdoshëm në këtë projekt, sepse në to do të realizohet praktika profesionale e studentëve.

Përmes riorganizimit të këtyre programeve të studimeve, përmirësohet formimi praktik dhe aftësitë praktike të studentëve, si dhe forcohet lidhja midis studimeve universitare dhe nevojave të tregut të punës.



Ky projekt krijon edhe një kuadër institucional modern (rregullorë, akte administrative, udhëzues, etj) për marrëveshjet dhe kontratat midis universitetit dhe fermave/bizneseve të bujqësisë, blegtorisë dhe industrisë agroushqimore.



Partnerët e projektit dhe kontaktet

Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ekonomi dhe Mjedis Nuertingen-Geislingen, Gjermani

Prof. Dr. Heinrich Schuele

heinrich.schuele@hfwu.de

Universiteti i Shkencave të Aplikuara Savonia, Finlandë

Dr. Ardita Jahja-Hoxha

ardita.hoxha-jahja@savonia.fi

Universiteti Bujqësor i Tiranës, Shqipëri

Prof. Dr. Anila Hoda

ahoda@ubt.edu.al

Universiteti "Fan Noli" Korçë, Shqipëri

Prof. Dr. Gjergji Mero

gmero@unkorce.edu.al

Universiteti i Prishtinës „Hasan Prishtina”, Kosovë

Prof. Dr. Skender Muji

skender.muji@uni-pr.edu

Universiteti "Isa Boletini" Mitrovicë, Kosovë

Dr. Bahtir Hyseni

bahtir.hyseni@umib.net

Qendra e Blegtorisë dhe Zhvillimit Rural, Tiranë, Shqipëri	Prof. Dr. Gori Stefi	gori.stefi@gmail.com
Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, Prishtinë, Kosovë	Kujtim Uka	kujtim.uka@rks-gov.net
Shoqata e Prodhuesve të Qumështit, Kosovë	Gente Kadriu	kadriugenta@gmail.com
Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Korçë, Shqipëri	Rolandi Meçaj	rmecaj93@gmail.com
Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Tiranë, Shqipëri	Dr. Xhiliola Bixheku	xhiliola.bixheku@ascal.al
Shoqata AGRINET, Korçë, Shqipëri	Tomi Pikuli	tomi_pikuli@yahoo.com
Nucleus Shqipëri	Valbona Paluka	valbona.paluka@nucleus.al

Text & Layout

Bahtir Hyseni, University "Isa Boletini" of Mitrovica
 Myqerem Tafaj, Agricultural University of Tirana
 Anna Borsuk, University Nuertingen-Geislingen
<https://stripo.email/de>

© 2020-2024, DualAFS.

All rights reserved.

Pictures

© Nucleus Albania
 © Faculty for Agriculture and Veterinary, University of Prishtina